



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 3333/prot.
4

Pogradec, më 29, 08 2023

VENDIM

NR. 91, DATË 28.08.2023

PËR

“MIRATIMIN E PLANIT TE MASAVE PER TE DALE NGA GJENDJA ME PROBLEME
FINANCIARE”

Në mbështetje të, ligjit nr. 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore"; Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Per menaxhimin e sistemit buxhetor te Republikës te Shqiperise", i ndryshuar, te nenit 55 te ligjit nr 68 dt 17.04.2017” Per financat e vetqeverisjes vendore” dhe Udhezimit te Ministrise se Financave dhe Ekonomise nr 26 dt 27.09.2019 “Procedura per menaxhimin e veshtiresive financiare per njesite e vetqeverisjes vendore” dhe të Buxhetit Vjetor 2023 Bashkia Pogradec, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Pogradec, Këshilli Bashkiak:

VENDOSI:

1. Të miratojë Planin e masave per te dale nga gjendja me problem financiare.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Ekonomisë dhe Menaxhimit Financiar , të gjitha ndërmarjet në varësi të Bashkisë Pogradec .
3. Ky Vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes .

KRYETARË E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____, 2023

PLANI I MASAVE PER TE DALE NGA GJENDJA ME PROBLEMEVE FINANCIARE

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të kushtetutes së Republikës së Shqipërisë, të nenit 55 të ligjit nr 68 dt 17.04.2017 "Per financat e vetqeverisjes vendore" dhe Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr 26 dt 27.09.2019 "Procedura për menaxhimin e vështiresive financiare për njësitë e vetqeverisjes vendore", më poshtë po ju paraqesim Planin e masave për daljen nga gjendja me Probleme Financiare.

Plani i shlyerjes prej 25,000,000 lekë kundrejt vendimeve gjyqësore është e pamundur të likujdohet nga ana jonë. Kjo shumë është planifikuar në fillim të vitit dhe është planifikuar nga të ardhurat e Bashkisë. Për shkak të shpenzimeve për funksionimin normal të Bashkisë dhe mbledhjes jo në masën e duhur të të ardhura Bashkia gjatë muajve Janar- Korrik 2023 nuk ka bërë asnjë shlyerje për detyrimet e prapambetura.

Të ardhurat nuk kanë qënë në masën e planifikuar për disa shkaqe:

1. Mosmiratimi i Planit të Përgjithshëm Vendor përgjatë 6 mujorit të parë të vitit 2023, nuk na lejon që të mbledhim taksën e ndikimit në infrastrukturë. Kjo taksë ka shumë më të madhe të planifikuar në Buxhetin e vitit 2023. Kjo nuk na lejon ne si Bashki që të japim leja ndërtimi.
2. Për tokat që Bashkia Pogradec ka në territorin e saj, të ardhurat që gjenerohen i merr Ministria e Bujqësisë dhe Zonat e Mbrojtura. Kjo bën që Bashkia mos ketë mundësi të mbledh të ardhurat për tokat të cilat janë në territor të saj dhe ka të drejtë legjitime mbi ato.
3. Për shkak të rritjes së pagës minimale dhe pagave të specialistëve, Bashkia është ndodhur në vështirësi pasi kjo rritje do të mbulohej nga të ardhurat e veta.

Në bazë të analizës 4 mujore të dorëzuar më parë pranë jush (Raporti i Monitorimit Janar-Prill 2023) rezultojnë që jemi në një nivel 17.03% përsa i përket raportit ndërmjet Totalit të shpenzimeve dhe stokut, sipas tabës së mëposhtme.



N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në	Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së
I	Borxhe (a+b)	0		
a	Hua afatgjatë	0		
a,1	Principali			
a,2	Interesi			
b	Hua afatshkurtër	0		
b,1	Hua			
b,2	Overdrafte			
b,3	Kredi të furnitorëve			
II	Detyrime (a+b+c)	240,541,911		17.03%
a	Shpenzime korrente	117,491,451		
a,1	Mallra dhe shërbime	89,023,900		
a,2	Paga dhe sigurime			
a,3	Të tjera	28,467,551		
b	Shenzime kapitale	65,169,028		
b,1	Insitucione buxhetore			
b,2	Subjekte private	65,169,028		
c	Vendime gjyqësore	57,881,432		
c,1	Marrëdhënie pune	8,247,344		
c,2	Mallra dhe shërbime	49,634,088		
c,3	Investime			
c,4	Të tjera			
III	Totali (I+II)	240,541,911	1,412,846,792	17.03%

Duhet të theksojmë se detyrimet e prapambetura janë të krijuaja në vitin 2009 më i hershmi dhe vazhdojnë deri në 2015. Përgjatë viteve në vazhdim Bashkia nuk ka krijuar borxhe të tjera përveç detyrimeve për vendime gjyqësore.

Për shkak të problemeve të sipërcituara por dhe problem të tjera Bashkia Pogradec planifikon një plan masash për likuidim si më poshtë:

Nr	Muaji	Shuma
1	Shtator 2023	500,000
2	Tetor 2023	500,000
3	Nentor 2023	500,000
4	Dhjetor 2023	500,000
5	Janar 2024	500,000
6	Shkurt 2024	500,000
7	Mars 2024	500,000
8	Prill 2024	500,000
9	Maj 2024	500,000
10	Qershor 2024	500,000
11	Korrik 2024	500,000
12	Gusht 2024	500,000
13	Shtator 2024	500,000
	Total	6,500,000

Ulja e shumës për likuidim të detyrimeve të prapambetura është e nevojshme për shkak të funksionimit normal të punës në muajt në vazhdim. Shuma e re e planifikuar është e përballueshme nga Bashkia.

Përgjate muajve në vazhdim Bashkia do të kryejë shpenzimet e nevojshme dhe do të studiojë gjëndjen e saj. Pezullimi i veprimtarive ekonomike do të kryhet nëse do të jetë një domosdoshmeri. Kerkojme nga ana juaj miratimin e planit të mesiperm dhe presim rekomandime për funksionimin e muajve në vazhdim.

